

PËRMBAJTJA

<i>-Hyrje.....</i>	<i>2.</i>
<i>-Raporti i monitorimit të buxhetit të INSTAT-it janar - dhjetor e vitit 2020.....</i>	<i>2-3.</i>
<i>-Analiza e realizimit të buxhetit të INSTAT-it janar - dhjetor e vitit 2020.....</i>	<i>4-10.</i>
<i>-Aneksi Nr. 1-Raporti i shpenzimeve sipas programeve.....</i>	<i>11.</i>
<i>-Aneksi Nr. 2-Raporti i shpenzimeve të programit sipas artikujve buxhetorë</i>	<i>12.</i>
<i>-Aneksi Nr. 3-Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit</i>	<i>13.</i>
<i>-Aneksi Nr. 4-Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit</i>	<i>14.</i>
<i>-Aneksi Nr. 5-Projektet e investimeve me financim të brëndshëm dhe të huaj.....</i>	<i>15.</i>

HYRJE

Monitorimi i buxhetit të INSTAT për vitin 2020 përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e INSTAT-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të INSTAT-it të përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të INSTAT-it të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor, nëpërmjet treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë rorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

PROGRAMI 01320 “VEPRIMTARIA STATISTIKORE”

Buxheti i akorduar për programin “*Veprimtaria statistikore e INSTAT-it*”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA 2021-2023 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit.

INSTAT, mbështetur në Ligjin Nr.17, datë 05.04.2018 “Për Statistikat Zyrtare” është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Programi i Statistikave Zyrtare, 2017-2021, përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore. Programi përmban aktivitetet statistikore, të cilat janë në funksion të zbatimit të strategjisë dhe prioritetëve të institucionit.

Politika e këtij programi konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjëndjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare, në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Institucionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e objektivave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve të vendosura nga BE, në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të INSTAT-it.

Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.
- Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.
- Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.
- Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

- Përmirësimin e cilësisë së realizimit të vërtetimeve, duke përdorur teknika moderne për grumbullimin e përpunimin e të dhënave, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve mbështetës nëpërmjet trajnimeve.
- Zgjerimin e fushës së mbulimit me aktivitete të reja sipas kërkesave të përdoruesve dhe të rrisë numrin e njësive statistikore (njësi ekonomike dhe familje) të intervistuar në vërtetimet statistikore.
- Paraqitjen e një produkti statistikor të përmirësuar cilësor dhe sasior tek përdoruesit nëpërmjet publikimeve statistikore, zhvillimit të konferencave, interpretimit të tyre me mjete të ndryshme komunikimi.
- Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar një menaxhim të lartë administrativ të burimeve financiare dhe njerëzore.
- Përditësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të përpunimit të të dhënave.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale dhe kompjuterike për përpunimin e të dhënave, si dhe të krijohen kushte të përshtatshme pune për punonjësit nëpërmjet mobilimit të zyrave.

RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2020


Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2020, i miratuar me ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar është 758,624 mijë lekë.

Këto fonde, INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistikore”, si më poshtë:

Mijë lekë

Artikulli	Emërtimi i artikullit	Buxheti fillestar vjetor 2020	Buxheti rishikuar vjetor 2020
6000000	Pagat	616,870.0	403,170.0
6010000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	102,996.0	67,396.0
6020000	Mallra dhe shërbime	217,560.0	80,860.0
6040000	Transferta korrente të brëndshme	1,574.0	1,574.0
6060000	Transferta buxhetesh familjare	0.0	623.7
	Totali i shpenzimeve korrente	939,000.0	553,623.7
	Investime nga buxheti	94,000.0	74,000.0
	Financim i huaj	300,000.0	131,000.0
	TOTALI	1,333,000.0	758.623.7

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Siç shihet nga tabela, zëri “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetsore” zë 62% të buxhetit, zëri “Mallra dhe Shërbime” zë 11% të buxhetit, zëri “Investime nga buxheti” zë 10% të buxhetit dhe zëri “Financim i huaj” zë 17% të buxhetit.

Ndryshimi i buxhetit ka ardhur kryesisht nga mos kryerja e CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË INSTAT PËR VITIN 2020

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2020 krahasuar me planin e vitit, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

<i>“Veprimtaria statistikore”</i>		Mijë lekë		
Artikulli	Emërtimi i artikullit	Plani Vjetor i Rishikuar	Fakti vjetor 2020	% e Realizimit plan/fakt vjetor
6000000	Paga, sigurime shoqërore dhe shëndetsore	470,566.0	455,587.0	96.8
6020000	Mallra dhe shërbime	80,860.0	46,667.5	57.7
6040000	Transferta korrente të brëndshme	1,574.0	622.2	39.5
6060000	Transferta për buxhete familjare	623.7	623.7	100.0
	Totali i shpenzimeve korrente	553,623.7	503,500.3	90.9
2310000	Investime	74,000.0	44,766.8	60.5
	Totali i buxhetit	627,623.7	548,267.1	87.3
	Financim i huaj	131,000.0	29,622.7	22.6
	Totali të ardhura jashtë limiti		49,180.0	
	Shpenzime korrente		27,832.5	
	Investime		21,347.5	
	TOTALI	758,623.7	627,069.8	82.7

1- **“Paga, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”. Llogaria 600-601**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit i ndryshuar për vitin 2020 për zërin “Paga dhe Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore” është 470,566 mijë lekë, nga të cilat janë shpenzuar 455,587.0 mijë lekë, ose 96.8% e planit vjetor 2020.

Në zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfshin pagat e punonjësve të strukturës të INSTAT-it, si dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, për organizimin dhe zhvillimin e anketave, mbështetur në përlogaritjen e numrit të punonjësve të domosdoshëm sipas pozicioneve, duke mbajtur parasysh kontributin e çdo pozicioni në secilën anketë.

Ndryshimet në buxhet për zërin “Paga dhe Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore” janë bërë sipas aktit normativ nr.6 datë 24.03.2020 ku u pakësuan 180 milion lekë si dhe aktit normativ nr.15 datë 15.04.2020 ku u pakësuan 17 milion lekë si dhe VKM nr. 936, datë 16.12.2020 ku u pakësuan 52.300 mijë lekë.

Mos realizimi ka ardhur kryesisht nga mos plotësimi mesatarisht i 15 vëndeve vakante të strukturës organike dhe ndryshimi i metodologjisë, i mbledhjes së të dhënave të cilët u bënë nëpërmjet bisedave telefonike nga anketuesit për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.

Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 36 proçedura punësimi, ku 24 proçedura kanë përfunduar me fitues, 5 proçedura pa fitues dhe 5 proçedura të tjera kanë qënë në proçes. 2 fitues kanë dhënë dorëheqjen.

2- “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”. Llogaria 602

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit i ndryshuar për vitin 2020 për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” është 80,860 mijë lekë dhe janë shpenzuar 46,667.5 mijë lekë ose 57.7% e planit vjetor.

Ndryshimet në buxhet për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” janë bërë sipas aktit normativ nr. 6 datë 24.03.2020 ku u pakësuan 120 milion lekë si dhe aktit normativ nr.15 datë 15.04.2020 ku u pakësuan 9 milion lekë si dhe VKM nr. 936, datë 16.12.2020 ku u pakësuan 7,700 mije lekë.

Mos realizimi ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i procedurave të prokurimeve si dhe mos zhvillimi i trajnimeve, udhëtimeve jashtë vëndit dhe dietave të punonjësve për shkak të Pandemisë së Covid-19.

Procedurat e pa realizuara janë:

1. “Shërbim interneti: 3G modem USB+karta sim dhe 4G”, me fond limit 1,339,000 lekë, pa tvsh;
2. “Workshope/ konferenca për aktivitete të ndryshme”, me fond limit 1,500,000 lekë, pa tvsh;
3. “Blerje ujë, kafe, dhurata etj., për pritje delegacione” me fond limit 370,000 lekë, pa tvsh;
4. “Video të animuara informuese për produktet e INSTAT” me fond limit 1,500,000 lekë, pa tvsh;
5. “Shërbim gjelbërimi” me fond limit 400,000 lekë, pa tvsh.

3- “Transferta korrente të brëndshme”. Llogaria 604

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 për zërin “Transferta korrente të brëndshme” është 1,574 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 622.2 mijë lekë, ose 39.5 % e fondit.

Mosrealizimi ka ardhur nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19 ku për Këshillin e statistikës janë realizuar 4 mbledhje dhe për Komisionin e nomenklaturës janë realizuar 2 mbledhje dhe mos pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve .

4- “Transferta për buxhete familjare”. Llogaria 606

Gjatë vitit 2020 për zërin “Transferta për buxhete familjare” janë shpenzuar 623.65 mijë lekë, ose 100 % fondit për daljen në pension të 4 punonjësve, dhe 9 raste fatkeqësie.

5- “Shpenzime për Investime”. Llogaria 231

Bazuar në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, plani i buxhetit i ndryshuar për “Shpenzime për Investime” nga buxheti është në shumën 74 milion lekë.

Ndryshimet në buxhet për zërin “Investime” janë bërë bazuar në shkresën numër 12507/84 datë 23.07.2020 ku u pakësuan 20 milion lekë.

Realimi i Investimeve me Financim të Brendshëm është 44,766.8 mijë lekë ose 60.5 %.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm sipas zërave është realizuar si më poshtë;

Emertimi	Plani	Fakti	Mijë lekë
			Realizimi %
Blerje Liçenca	3,819.00	3,819.00	100.0
Blerje Paisje Kompjuterike	50,711.00	29,524.80	58.2
Likujdim TVSH	16,470.00	11,423.00	69.4
Blerje Gjeneratori	3,000.00		0.0
Totali Investime	74,000.00	44,766.80	60.5

Mosrealizimi për zërin “Blerje paisje kompjuterike”, ka ardhur si rezultat i mos zhvillimit të procedurës së prokurimit për **Blerje tableta** si pasojë e shtyrjes së CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020. Për zërin “Blerje Gjeneratori” procedura e tenderimit u zhvillua por rezultoi pa fitues.

Bazuar në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, plani i buxhetit i ndryshuar për “Investime me Financim të Huaj” është në shumën 131 milion lekë.

Ndryshimet në buxhet për zërin “Financim të Huaj” janë bërë bazuar në aktin normativ 34 datë 18.12.2020 ku u pakësuan 169 milion lekë.

Realizimi i shpenzimeve me “Financim të Huaj” është 29,622.7 mijë lekë ose 22.6%.

Mosrealizimi ka ardhur sepse në planin e zërit Financim të huaj përfshihet projekti Mbështetje për CENS 2020 por shpenzimet për projektin raportohen nga CFCU.

Projektet që menaxhohen nga INSTAT-i janë si më poshtë;

1. SALSTAT - Statistika te Forta Vendore.
2. Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.
3. Mbështetje për CENS 2020

6- Shpenzime nga të “Ardhurat jashtë limitit”

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për vitin 2020 janë 49,180.0 mijë lekë nga të cilat shpenzime operative 27,832.5 mijë lekë dhe investime 21,347.5 mijë lekë. Shpenzimet operative nga të ardhurat jashtë limitit janë bërë për anketën e matjes të nivelit të të ardhurave, anketën e shëndetësisë EHIS, për anketën e migracionit dhe PPP-së. Shpenzimet për investime përfshijnë blerjen e paisjeve kompjuterike për CENS-in e Popullsisë dhe Banesave nga UNFPA.

Gjatë vitit 2020 janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve sipas afateve ligjore.

INSTAT-i nuk ka detyrime të prapambetura.

Realizimi i shpenzimeve sipas produkteve për vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Llogaria Ekonomike	Produkti	Output Code	Plani vjetor	Mijë lekë	
				Fakt vjetor	% Realizimit
6000000	Njësi statistikore të vrojtura	95001AA	210,994.0	198,869.1	94.3
6010000		95001AA	35,423.0	33,000.0	93.2
6020000		95001AA	18,108.0	3,067.3	16.9
	Totali i njësisve statistikore të vrojtura		264,525.0	234,936.4	88.8
	Të dhëna statistikore të publikuara	95001AB	3,920.0	0.0	0.0
6000000	Personel i trajnuar	95001AC	192,176.0	191,911.3	99.9
6010000		95001AC	31,973.0	31,806.6	99.5
6020000		95001AC	58,662.0	43,600.1	74.3
6060000		95001AC	1,574.0	622.2	39.5
6040000		95001AC	623.7	623.7	100.0
	Totali personel i trajnuar		285,008.7	268,563.9	94.2
6020000	Auditime të kryera.	95001AD	170.0	0.0	0.0
2310000	Infrastrukturë e nevojshme software- të përditësuara	M500011	3,819.0	3,819.0	100.0
2310000	Pajisje të teknologjisë së informacionit të blera	M500002	50,711.0	29,524.8	58.2
2310000	TVSH	M500005	16,470.0	11,423.0	69.4
2310000	Blerje Gjeneratori	18CE902	3,000.0	0.0	0.0
	Totali investime nga buxheti		74,000.0	44,766.8	60.5
2310000	Financim i Huaj	GM50002	131,000.0	29,622.7	22.6
	Te ardhura jashtë limitit		0	49,180.0	0
	TOTALI		758,623.7	627,069.8	82.7

Shpenzimet për “Njësi statistikore të vrojtuar” janë 234,936.4 mijë lekë ose 88.8% e krahasuar me planin vjetor, shpenzimet për “Personel i trajnuar” janë 268,563.9 mijë lekë ose 94.2%.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Mijë lekë

	SHPENZIMET	Plani Vjetor	Fakti Vjetor	% Realizimit
	Shpenzime operative	553,623.7	503,500.3	90.9
	Investime	74,000.0	44,766.8	60.5
	Totali i buxhetit	627,623.7	548,267.1	87.3
	Financim i Huaj	131,000.0	29,622.7	22.6
	Te ardhura jashtë limitit	0	49,180.0	0
	TOTALI	758,623.7	627,069.8	82.7

Për programin e *Veprimtarisë Statistike* për vitin 2020 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 548,267 mijë lekë, ose 87.3 % ndaj planit vjetor, nga *Financimi i huaj* janë shpenzuar 29,622.7 mijë lekë ose 22.6%, nga të *Ardhurat jashtë limitit* janë shpenzuar 49,180 mijë lekë, në total janë shpenzuar 627,069.8 mijë lekë.


Realizimi i shpenzimeve sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Veprimtaria statistikore

Mijë /lekë

		VITI	2020		
Art	SHPENZIMET	Plani vjetor	Plani i vjetor i rishikuar	Fakti vjetor	% e Realizimit plan/fakt vjetor
600	Paga, sigurime shoqërore e shendetsore	719,866.0	470,566.0	455,587.0	96.8
602	Mallra dhe shërbime te tjera	219,134.0	83,057.7	47,913.3	57.7
231	Investime	94,000.0	74,000.0	44,766.8	60.5
	Totali	1,033,000.0	627,623.7	548,267.1	87.3

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, mbi totalin e tyre paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Referuar Regjistrit të Realizimeve të Prokurimeve Publike, për vitin 2020 janë realizuar gjithësej:

- 18 proçedura prokurimi – Kërkesë për propozim
- 3 proçedura prokurimi – Sistem dinamik për blerje e biletave të avionit
- 19 proçedura prokurimi – Blerje me vlerë të vogël
- 6 proçedura prokurimi – Blerje me vlerë nën 100.000 lekë pa tvsh

Zërat e regjistrit të planifikuar dhe të pa finalizuar dhe/ose të pafilluar janë si më poshtë:

6. “Shërbim interneti: 3G modem USB+karta sim dhe 4G”, me fond limit 1,339,000 lekë, pa tvsh;
7. “Workshope/ konferenca për aktivitete të ndryshme”, me fond limit 1,500,000 lekë, pa tvsh;
8. “Blerje gjenerator për serverat e INSTAT”, me fond limit 2,490,000 lekë, pa tvsh;
9. “Blerje ujë, kafe, dhurata etj., për pritje delegacione” me fond limit 370,000 lekë, pa tvsh;
10. “Video të animuara informuese për produktet e INSTAT” me fond limit 1,500,000 lekë, pa tvsh;
11. “Shërbim gjelbërimi” me fond limit 400,000 lekë, pa tvsh.

➤ Janë ndjekur dhe realizuar proçedurat e prokurimit me donatorë, si më poshtë:

1. “Printing questionnaires, Domestic Tourism Survey”. (*Printim pyetësorësh*)
2. “Purchase of 272 laptops for Cens”. (*Blerje 272 laptopa për Cens*)
3. “Purchase of Windows Server Data Center Edition Remote Desktop Services CAL for 5 users”. (*Blerje CAL-5 përdorues*)
4. “Printing questionnaires ASN”. (*Printim pyetësorësh ASN*)
5. “Training of field staff”. (*Trajnim stafi*)
6. “Purchase of two SPSS licenses”. (*Blerje 2 licensa SPSS*)
7. “Expertise in preparin reports on SMEI survey results and SAT results” (*Ekspertizë në raportet paraprake mbi rezultatet e studimit SMEI dhe rezultatet e SAT*)
8. “Expert selection”. (*Përzgjedhje eksperti*);

9. "Purchase of IT equipment (microsoft teams, webcams and desktop speakers)" (*Blerje pajisje kopmujterike, microsoft teams, kamera web-i dhe bokse*);
10. "Disinfection service of the INSTAT office" (*Dizinfektim te zyrave INSTAT*);
11. "Purchase of goods for protection against Covid-19 virus" (*Blerje mallra për mbrojtje kundër virusit Covid-19*);
12. "Purchase of goods to cope the situation created by the Covid-19 pandemic" (*Blerje mallra për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19*);
13. "Disinfection service of the INSTAT office" (*Dizinfektim te zyrave INSTAT*);
14. "Purchase of office materials" (*Blerje materiale zyre/kancelarie*);
15. "Purchase of computers and other assistive supplies for INSTAT regional statistics offices" (*Blerje pajisje kompjuterike për zyrat rajonale të INSTAT*).

Realizimi në sasi sipas produkteve për periudhën 12-mujore paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Plan	Fakt	% Real
1	Njësi statistikore të anketuara	249,616	203,304	81
2	Të dhëna të publikuara	55	55	100
3	Personel i trajnuar	236	218	92
4	Auditime të kryera	9	5	56
5	Blerje Liçensa	10	10	100
6	Blerje paisje kompjuterike	2,740	5	0

Treguesi i performancës/produktit "Njësi Statistikore të anketuara" është realizuar 81% e planit vjetor. Mos realizimi ka ardhur si pasojë e pandemisë së Covid-19, ku dy anketa të Bankës së Shqipërisë Shërbimet e udhëtimit (Turizmi) dhe Dërgesat e emigrantëve nuk u zhvilluan me kërkesën e vetë BSH-së.

Treguesi i performancës/produktit "Të dhëna të publikuara" është realizuar 100%.

Treguesi i performancës/produktit "Personel i trajnuar" është realizuar 92%.

Treguesi i performancës/produktit "Auditime të kryera" është realizuar 56%. (Mosrealizimi si pasojë e pandemisë së Covid-19).

Treguesi i performancës/produktit "Blerje Liçensa" është realizuar 100%.

Treguesi i performancës/produktit "Blerje paisje kompjuterike" nuk është realizuar. Mosrealizimi ka ardhur si pasojë e shtyrjes së CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Elsa DHULI